URDHËR
Nr. 369 datë 19.9.2019

PËR HAPJEN E THIRRJES SË DYTË PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN IPARD II

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar, në Marrëveshjen Kuadër, Marrëveshjen Sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjen e Financimit,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë për aplikime nga Programi IPARD II, për aplikimet, respektimin e kërkesave për informimin, publicitetitn dhe transparencës, me qëllim garantimin e vizibilitetit dhe llogaridhënien e fondeve të BE-së.

2. Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në Udhëzuesin për Aplikantët lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohet si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00–16:30.

3. Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të shkarkohen në versionin zyrtar nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al dhe http://www.bujqësia.gov.al.

4. **Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 30 tetor 2019 deri në datën 16 dhjetor 2019 sipas orarit zyrtar 08:00–16:30. Çdo aplikim i mbërritur në AZHBR pas datës 16 dhjetor 2019 do të refuzohet.**

5. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në zarfe të mbyllura me titullin thirrje për dorëzimin e aplikimeve, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin "Të mos hapet përpara dorëzimit".

6. Aplikimet duhet të dorëzohen ose:

- nëpërmjet dërgesës postare rekomande; ose
- dorazi (duke përfshirë shërbimet koriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga: Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Rruga "Muhamet Gjollesha", nr. 56, Tiranë, Shqipëri.

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORE E PËRGJITHSHME
Frida Krifca